



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 38 VENDIMI

Tiranë, më 17.7.2018

V E N D I M

Trupa gjyquese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Roland Ilia	Anëtar
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore znj. Ina Serjani, pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit dhe relatorit, sot, më datë 17.7.2018, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

Znj. Merita XHANI – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës

BAZA LIGJORE : Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Nenet 14 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

RETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, Znj. Merita Xhani, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Për shkak të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Konstatohet se Znj. Merita Xhani ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nga data 04.03.1994 deri më 08.02.2018, datë në të cilën ka dhënë dorëheqjen.

Me shkresën protokolluar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me nr. 523 prot., datë 08.02.2018, me lëndë “Kërkesë”, Znj. Xhani ka paraqitur dorëheqjen nga funksioni i gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në vijim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, pasi mori në shqyrtim këtë kërkesë, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes së gjyqtarës Merita Xhani, mbështetur në nenet 63, 64 dhe 160, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Me kërkesë nr. 1136/1, datë 24.05.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimi nr. 29, datë 07.05.2018, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u vu në dispozicion më datë 01.06.2018.

ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TE RIVLERËSIMIT

Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit, që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

Neni 56 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfutojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.”

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave si vijon:

“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfutojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfutojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës.”

Me paraqitjen e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit Merita Xhani “nga funksionet e magjistratit” dhe me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për mbarimin e këtij statusi.

Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Kjo sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupa gjyqese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, Znj. Merita Xhani, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës të subjektit të rivlerësimit për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.
4. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 17.7.2018.

ANËTARËT E TRUPËS GJYKUESE

XHENSILA PINE

Kryesuese

GENTA Tafa (BUNGO)

Relatore

ROLAND ILIA

Anëtar

INA SERJANAJ

Sekretare gjyqësore

